

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për Disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Jo e zbatueshme
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Plani i Veprimit për adresimin e rekomandimeve të Komitetit Moneyval/ Vendimi nr. 01, datë 04.09.2018 i Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP)
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	23 janar 2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	15.01.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	PO, 13.02.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019-MFE-05
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Hava Delibashi 0684381875 hava.delibashi@financa.gov.al Artan Shiqerukaj ashiqerukaj@fint.gov.al Tel: +355 4 224 0691
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Sistemi shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të Raundit të 5^{të} Vlerësimit për Shqipërinë kryer nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës, që është organi rajonal që vlerëson për vendin tonë përputhshmërinë me rekomandimet e FATF. Ky vlerësim ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të përputhshmërisë teknike me Rekomandimet e FATF-së. Për sa i përket përputhshmërisë teknike, 10 rekomandime janë vlerësuar të përmbushur pjesërisht siç janë vendet me risk të lartë ku edhe pse Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave nxjerr listë të vendeve me risk më të lartë, dhe vendosë kundërmasa, mungon kërkesa e ndërhyrjes proporcionalisht me rreziqet e evidentuara; Vigjilenca e duhur ndaj klientit, ka disa mangësi të përmendura por me një rëndësi të vogël; Hetimi dhe ndjekja e pastrimit të parave, ku vetëm një pjesë e vogël (dhe në zvogëlim) e procedimeve të pastrimit të parave të regjistruara përfundojnë me ngritje akuzë para	

gjykatës, ndërkohë që shumica dërmuese e hetimeve për pastrim parash pezullohen ose pushohen nga prokuroria kompetente.

Ligji 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar nuk parashikon asnjë detyrim të shprehur për të identifikuar, vlerësuar dhe kuptuar risqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në funksion të përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe plotësimit të mangësive të Ligjit 9917/2008, lind nevoja e rregullimit të kuadrit ligjor.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat e propozimit janë:

- a) Të përafrohet kuadri ligjor në masën 100% me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar.
- b) Plotësimi i kuadrit ligjor për të bërë të mundur zbatimin nga Republika e Shqipërisë të detyrimit që rrjedh nga neni 13 i Konventës nr. 198 të KiE, “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit” ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9646 datë 27.11.2006.
- c) Të rriten masat për parandalimin e abuzimit me personat juridikë dhe marrëveshjet ligjore.
- d) Të bëhet i mundur akses i shpejtë në informacionin e kërkuar.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e diskutuara janë:

Opsioni 0 (status quo): të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues, ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar

Opsioni 1: Shfuqizimi i ligjit aktual dhe hartimi i një ligji të ri.

Opsioni nr. 2: Ndryshimi i ligjit aktual.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsionet e zgjedhura me ndryshime ligjore nuk kanë ndikim financiar në buxhet, ndërsa për subjektet raportuese kanë një ndikim financiar minimal në periudhën në vijim që nuk mund të përlogaritet për shkak të natyrës së këtij ligji, gamës së gjerë të subjekteve raportuese, llojit të masave shtesë të kërkuara, etj.

Për subjektet e zbatimit të ligjit ndikimet kanë të bëjnë me rritjen e njohurisë, si dhe të dhënave që këto subjekte duhet të mbajnë për klientët e tyre. Kjo do të sillte një rritje të

arkivave për subjektet zbatuese të këtij ligji, por mund të gjendej edhe një tjetër formë e mbajtjes së këtyre të dhënave në një format elektronik, për këtë arsye nuk mund të bëhet e mundur përlllogaritja monetare që do të kishin subjektet zbatuese.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i zgjedhur është opsioni nr. 2, kjo për dy arsye:

E para sepse do të ishte i mjaftueshëm për të arritur objektivat e vendosura, si edhe për të zgjidhur problemin e identifikuar.

E dyta sepse ndryshimet që propozohen në ligjin aktual nuk janë thelbësore dhe në një masë të konsiderueshme për nga teknika legjislative, pra nuk prekin ndryshim në mbi 50% të aktit

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji është hartuar me kontribut kryesor të Drejtorisë së Përgjithshme e Prandalimit të Pastrimit të Parave, dhe është konsultuar me bankat e nivelit të dytë, Shoqata e Bankave, shoqëritë e transfertave, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Ky konsultim ka konsistuar duke ju dërguar për mendim projektin të gjitha bankave të nivelit të dytë, Shoqatës së Bankave, dy shoqërive kryesore të transfertave, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Pas kësaj më datë 27.12.2018 janë realizuar dy takime, një me përfaqësues nga bankat, shoqëritë e transfertave dhe shoqatën e bankave si dhe tjetri me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, si dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Në takimet e realizuara janë diskutuar komentet dhe propozimet e më tej janë marrë në konsideratë një pjese e tyre, për aq sa nuk bien ndesh me rekomandimet e FATF dhe qëllimin e ndryshimeve të propozuara.

Projektligji është hedhur për konsultim në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe në regjistrin elektronik të konsultimeve por nuk ka pasur asnjë reagim nga palët e interesuara.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Prandalimit të Pastrimit të Parave dhe autoritetet mbikëqyrëse. Me ndryshimin e këtij ligji, do të ndryshohen disa akte nënligjore.

Drejtorja e Përgjithshme e Prandalimit të pastrimit të Parave do të monitorojë procesin me anë të inspektimeve dhe kontrolleve periodike lidhur me përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me kuadrin ligjor në fuqi.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Sistemi shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të Raundit të 5^{të} Vlerësimit për Shqipërinë kryer nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës, që është organi rajonal që vlerëson për vendin tonë përputhshmërinë me rekomandimet e FATF. Ky vlerësim ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të efektivitetit të sistemit Shqiptar kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/FT).

Sipas këtyre rekomandimeve, përpjekjet e vendit janë përqëndruar në sektorët e rregulluar. Të kufizuara janë përpjekjet për vlerësimin dhe zvogëlimin e risqeve të pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit jashtë këtyre sektoreve, si dhe të kërcënimeve dhe dobësive të mjegulluara nga praktikatat korruptive në sektorin publik.

Lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar thuhet se mekanizmi i përgjithshëm për zbatimin e kërkesave për dhënie ndihme juridike është tepër kompleks, ç'ka mund të shkaktojë vonesa, shtuar kjo mungesës së një sistemi prioritizimi të kërkesave të mbërritura.

Për personat juridikë dhe marreveshjet ligjore mangësi është mungesa e përgjithshme e ndërgjegjesimit lidhur me risqet e mundshme të abuzimit me personat juridikë dhe në vecanti me OJFtë për financimin e terrorizmit e cila është për tu shqetësuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave kryen hetime dhe ndjekje në fushën e pastrimit të parave por vetëm një pjesë e vogël (dhe në zvogëlim) e procedimeve të pastrimit të parave të regjistruara përfundojnë me ngritje akuzë para gjykatës, ndërkohë që shumica dërmuese e hetimeve për pastrim paras hese pezullohen ose pushohen nga prokuroria kompetente.

Gjithashtu Shqipëria ka mundur të demonstrojë vetëm pjesërisht që masat e sekuestrimit dhe konfiskimit zbatohen efektivisht në raste të pastrimit të parave dhe më gjerë lidhur me veprimtaritë kriminale që sjell produkte.

Lidhur me masat parandaluese dhe sanksionet financiare kundër financimit të terrorizmit nuk është siguruar zbatimi në kohë i Sanksioneve Financiare Specifike.

Mungon legjislacioni për zbatimin e sanksioneve financiare specifike në përputhje me rezolutat e KS të OKB lidhur me parandalimin, shtypjen dhe shkatërrimin e përhapjes së armëve të shkatërimit në masë dhe të financimit të tij.

Me këtë projektligj synohet përmbushje e një pjese të rekomandimeve dhe/ose kritereve përkatëse të rekomandimeve, me fokus ato që janë vlerësuar si të pa pambushura apo të përmbushura pjesërisht.

Në pasqyrim të gjetjeve të mësipërme dhe në funksion të rritjes së efektivitetit dhe përputhshmërisë teknike të sistemit tonë të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, janë përpiluar dhe amendamentet që përmban ky projektligj.

Nisma për hartimin e Projektligjit vjen në kuadër të:

1. Neni 13 i Konventës 198 së KiE, “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”
2. Rekomandimeve Grupit i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF)
3. Gjetjeve të Komitetit MONEYVAL;

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*

- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Komiteti i MONEYVAL ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të efektivitetit të sistemit dhe përputhshmërisë teknike me Rekomandimet e FATF-së të cilat janë:

1. Vlerësimi i risqeve dhe aplikimi i qasjes bazuar mbi riskun:

Ligji 9917/2008 nuk parashikon asnjë detyrim të shprehur për të identifikuar, vlerësuar dhe kuptuar risqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (ML/TF).

Nuk është e qartë nëse kërkesa për vigjilencë të zgjeruar përfshin rastet kur faktorë më të lartë risku zbulohen apo dalin gjatë zhvillimit të transaksionit apo marrëdhënies së biznesit. Për më tepër mungojnë udhëzime të mëtijshme të masave që duhen zbatuar në rast identifikimi të risqeve të ndryshme nga kategoritë e parashikuara në ligj (PEP-ët, etj).

2. Vigjilenca e duhur ndaj klientit:

Ka disa mangësi të përmendura por me një rëndësi të vogël, ca të tjera janë më thelbësore si p.sh kërkesat e paplota lidhur me personat e autorizuar dhe përfituesit në kontratat sigurimit të jetës.

Kërkesat për menaxhimin efektiv të risqeve në rast të shtyrjeje të verifikimit të klientit dhe pronarit përfitues, dhe për të zhvilluar vigjilencë të zgjeruar në rast identifikimi të risqeve më të larta, përmendin vetëm risqet ML dhe jo risqet FT.

3. Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP)

Boshllëqet e ngelura sado të vogla (jo të gjithë politikanët/ zyrtarët e lartë të partive politike të mbulua; PEP-at e organizatave ndërkombëtare nuk mbulohen; kufizimi i mandatit për PEP-at e brendshëm) nënkuptojnë që Shqipëria nuk përputhet plotësisht me Standardin e FATF.

4. Transfertat

Ka mangësi lidhur me detyrimet për të verifikuar informacionin dhe detyrimet për ndërmjetësit. Mungon një parashikim ligjor për subjektet raportuese që të ngrijnë pa vonesë asetet dhe fondet që janë sanksionuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së.

5. Mbështetja në palë të treta

Shqipëria nuk lejon Mbështetjen në palë të treta.

6. Kontrollat e brendshme dhe degët e bijat e huaja;

Shqipëria nuk ka adresuar kontrollat e brendshme lidhur me AML/CFT në një mënyrë koherente dhe gjithëpërfshirëse, duke dështuar në adresimin e përshtatshëm të implementit të masave të shoqërive tregtare të grupit në këtë fushë.

Elementët e kërkesës për të zbatuar masa parandaluese në një shtet të huaj nuk mbulohen në tërësi.

7. Vendet me risk të lartë;

Edhe pse DPPP nxjerr listë të vendeve me risk më të lartë, dhe të vendosë kundërmasa, mungon kërkesa e nderhyrjes proporcionalisht me rreziqet e evidentuara.

8. Mbajtja e të dhënave

Ka mangësi të vogla lidhur me ruajtjen e analizave të kryera dhe me interpretimin e ngushtë të ligjit AML/CFT lidhur me çfarë përbën transaksion financiar dhe dokumentacion lidhur me identifikimin e klientit.

9. Mosdeklarimi dhe konfidencialiteti;

Fusha e zbatimit të sekretit profesional është e paqartë

10. Transparenca dhe pronarët përfitues të marrëveshjeve ligjore;

Kërkesa për të mbajtur dhe përditësuar informacionin nuk mbulon të gjitha llojet e informacionit sipas R25.

Trustëmbajtësit nuk detyrohen të njoftojnë subjektet raportuese për statusin e tyre, çka prek përputhshmërinë e Shqipërisë me disa nga kriteret.

Grupet të cilat do të preken nga ky ndryshim janë fondet e investimeve, organizimet ligjore si dhe çdo person që futet dhe del nga territori i Republikës së Shqipërisë i cili ka detyrimin ligjor të bëjë deklarimin e CASH-it në pikat kufitare.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Nevoja për të ndërhyrë ka lindur nga Raporti i Moneyval dhe me të synohet adresimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të Raportit. Nëpërmjet ndërhyrjes synohet përafrimi me Rekomandimet e FATF që janë detyruese për vendin tonë (më sipër të shpjeguara) dhe nëse nuk realizohet ky përafrim ka mekanizma të ndryshëm shtrëngues që nga monitorimi i përforcuar deri në vendosje të vendit në lista publike. Shkalla e ndërhyrjes së Qeverisë ligji synon rritjen dhe saktësimin e detyrimeve kundrejt subjekteve private (banka, institucione financiare, zyra këmbimi valutor etj). Pas ndryshimit të ligjit, do të ndryshojnë aktet nënligjore të cituara më sipër, por jo me ndryshime domethënëse, më shumë me karakter përafrimi me ndryshimet ligjore. Objektiv madhor dhe i përhershëm i qeverisë është lufta kundër financimit të terrorizmit, pastrimit të parave dhe krimit të organizuar, e shprehur kjo në dokumentet kryesore në fuqi. Puna kryesore e bërë deri tani ka të bëjë me hartimin e projektligjit.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

e) Të përafrohet kuadri ligjor në masën 100% me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar.

f) Krijimi i kuadrit ligjor për të bërë të mundur zbatimin nga Republika e Shqipërisë të detyrimit që rrjedh nga neni 13 i Konventës nr. 198 të KiE, “Për pastrimin, kërkimin,

kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit” ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9646 datë 27.11.2006.

g) Të rriten masat për parandalimin e abuzimit me personat juridikë dhe marrëveshjet ligjore.

h) Të bëhet i mundur akses i shpejtë në informacionin e kërkuar.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0 (status quo): Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, i cili është në fuqi nuk përmbush kriteret e vendosura nga Moneyval dhe rekomandimet e FATF.

Opsioni 1: shfuqizimi i ligjit të mëparshëm dhe hartimi i një ligji të ri. Gjatë shqyrtimit të këtij opsioni kemi pasur parasysh faktin që parashikimet ligjore të ligjit në fuqi do të vazhdojnë të jenë të vlefshme dhe nuk do të preken rregullimet thelbësore që bëhen nga ligji nr. 9917/2008.

Opsioni 2: ndryshimi i ligjit aktual. Ky opsion është i mjaftueshëm për arritjen e objektivave të vendosura, zgjidhjen e problemit të identifikuar dhe përmbushjen e rekomandimeve të MONEYVAL.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe rreziqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*

- o *Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Grupet që preken janë:

1. Subjektet e ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar. Subjektet duhet të marrin masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit në të gjitha rastet, kur ka dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit.
2. Fondet e investimeve / Shoqëritë apo bashkimi i aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si edhe shoqëritë administruese të tyre;
3. Organizimet ligjore.
Synohet që organizimet ligjore të bëjnë të ditur statusin e tyre tek subjektet raportuese kur të vendosin një marrëdhënie biznesi apo të kryejnë një transaksion mbi kufirin, si dhe që vigjilenca e duhur të përfshijë edhe detyrimin për të mbajtur informacionin bazik lidhur agjentët e rregulluar dhe ofruesit e shërbimeve për organizimet ligjore, duke përfshirë këshilltarët e investimeve apo menaxherët, llogaritarët dhe këshilltarët fiskal.
4. Çdo person fizik ose juridik, përveç atyre të specifikuar më sipër, të cilët merren me ofrimin shërbimeve të mjeteve virtuale.
5. Çdo person fizik ose juridik, përveç atyre të specifikuar më sipër, të cilët ofrojnë shërbimet e mëposhtme për një klient:
 - a) Vepron si agjent formimi i personave juridikë;
 - b) Duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprojë si një drejtor ose sekretar i një personi juridik, pjesëtar e një ortakërie, apo një pozitë të ngjashme në lidhje me persona të tjerë juridikë;
 - c) Duke siguruar një zyrë të regjistruar, akomodim ose adresë për biznesin, adresë zyrtare ose me korrespondence për një kompani, partneritet, person juridik apo organizime ligjore;
 - d) Duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprojë si i besuar i një organizimi ligjor të shprehur ose kryerja e funksionit ekuivalent për një formë tjetër organizimi ligjor;
 - e) Duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprojë si një aksionar dhe/ose ortak shoqërive që kanë aksione të mbajtësit për një person tjetër.
6. Institucioni financiar korespondent
7. Çdo person i cili hyn/largohet në/nga territori i Republikës së Shqipërisë;
8. Autoritetet doganore

Llojet e ndikimeve kanë të bëjnë në thelb me rritjen e njohurisë dhe të dhënave që subjektet e ligjit duhet të mbajnë për klientët e tyre, në kuadër të realizimit të vigjilencës së duhur dhe asaj të zgjeruar.

Efekte, të cilat mund të monetarizohen për institucionin nuk ka. Për subjektet e zbatimit të ligjit ndikimet kanë të bëjnë me rritjen e njohurisë, si dhe të dhënave që këto subjekte duhet të mbajnë për klientët e tyre, të kushtëzuara nga nevoja për zbatimin e tyre dhe për rrjedhojë nuk mund monetarizohen.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Bazuar në analizën e bërë më sipër, si edhe duke mbajtur në konsideratë masën e shtesave dhe ndryshimeve që ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar pëson, është vlerësuar se opsioni i preferuar është ai nr. 2, ndryshimi i ligjit egzistues.

Gjithashtu, rekomandimet ndryshe nga tranzpozimet e direktivave kërkojnë një përqasje më të lehtë me legjislacionin vendas, prandaj opsioni nr. 2 është i mjaftueshëm.

Rekomandimet e MONEYVAL dhe objektivat e vendosura nga FATF nuk prekin thelbin e ligjit aktual. është arritur në përfundimin se objektivat e vendosura mund të arrihen duke ndryshuar ligjin aktual.

Në respektim të teknikës legjislative, akti nuk do të pësojë ndryshim në mbi 50% të tij.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Njësia përgjegjëse e cila do të merret me zbatimin e këtij ligji është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, e mbikëqyrur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe autoritetet mbikëqyrëse.

Gjithashtu, për të bërë të mundur implementimin e tij do të ketë ndryshime edhe në një sërë aktesh nënligjore si më poshtë:

- a) Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 922 datë 21.12.2011 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionit të drejtorisë së përgjithshme të parandalimit të pastrimit të parave”;
- b) Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 871 datë 14.12.2011 “Për përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga DPPP”.
- c) Udhëzim i MFE nr. 28, datë 31.12.2012 “Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
- d) Udhëzim i MFE nr. 29, datë 31.12.2012 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare” i ndryshuar;

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të pastrimit të Parave do të monitorojë procesin me anë të inspektimeve dhe kontrolleve periodike lidhur me përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me kuadrin ligjor.

Kriteri tregues i arritjes së qëllimit do të jenë raporti i rradhës i MONEYVAL, i cili do të mbahet për të treguar masën e pasurimit të rekomandimeve të FATF në kuadrin ligjor vendas.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Anila Denaj